



Pranuar / Dërguar Punëpunë/Prerabot Received/Delivered	09.11.2023	3	viti and year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Kr. Prot Br./Prot Prot No	Shitje e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANESHICK	6659/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1117/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Ilire Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës A.nr.1117/2023 të datës 25.08.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted], nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1; Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.10.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1117/2023, e datës 25.08.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted].
- II. Anulohet** në tërësi procedura e rekrutimit me numër reference RN00010816, për grup të pozitive “Specialist të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane” i shpallur më datë 26.01.2023, nga Komuna e Prishtinës si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë e pranimit.
- III. Obligohet** Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Menaxheri i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në II të dispozitivit, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted], (tutje vetëm ankuesja), më datë 25.08.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e plotësuar më datë 29.08.2023, duke kontestuar Konkursin e pranimit për emrin e grupit “Specialistë të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane- Zyrtar

i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim”, me pretendimet ankimore së Komisioni i Pranimit nuk ka bërë vlerësim të drejtë të CV-së dhe intervistës me gojë të ankueses, shton së ka vërejtja në mënyrën e veprimit të anëtarit të Komisionit të Pranimit me inicialet F. K , i cili sipas ankuese ka ndërhyrë gjatë intervistës duke bërë komente dhe plotësuar përgjigjet e saj. Kërkon që Këshillit të kthejë çështjen në rishqyrtim në mënyrë që të behët vlerësimi korrekt i CV-së dhe të përsëritet intervista me gojë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 30.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 04.09.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6464/2023, të datës 09.10.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1117/2023, të datës 25.08.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5815 të datës 25.08.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës me numër protokollit 147 të datës 29.08.2023 të ankueses në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 22.08.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 28.08.2023 të Komisionit Vlerësues të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 28.08.2023 të Komisionit Vlerësues të Komunës së Prishtinës; Njoftimin e datës 28.08.2023 të Komunës së Prishtinës për përzgjedhjen e kandidatëve më të suksesshëm; Ankesën e parashtruar nga ankuesja lidhur me mënyrën e intervistës me gojë në Konkursin me numër reference RN00010816 tek Komisioni i Pranimit në Komunën e Prishtinës; Kopjen e letërnjoftimit të I.N; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.08.2023 të Këshillit për Komunën e Prishtinës; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 1117/2023 të datës 04.09.2023 të Komunës së Prishtinës për Këshillin bashkë me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes; Konkursin me numër reference RN00010816 të shpallur nga Komuna e Prishtinës të datës 26.01.2023 për emrin e grupit Specialistë të Planifikimit dhe Arkitekturës Urbane, pozita Zyrtar i lartë për Planifikim dhe Zhvillim; Vendimin për përbërjen e komisionit të pranimit në shërbimin civil me numër 14-020/04-80078/23 të datës 20.04.2023 të Komunës së Prishtinës; Listën e aplikantëve të aprovuar dhe lista e kandidatëve të refuzuar për konkursin me numër reference RN00010816; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 18.08.2023 për konkursin me numër reference RN00010816; Njoftimin e datës 29.08.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Njoftimin e datës 11.08.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Njoftimin e datës 03.03.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Njoftimin e datës 16.03.2023 të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Njoftimin e datës 21.06.2023 për intervistë me përmirsim të datës të dërguar nga Burimet Njerëzore të Prishtinës për I.N; Rikujtim për test me shkrim të datës 09.06.2023 të dërguar nga Burimet Njerëzore të Prishtinës; Aplikacionin e kandidates I.N të datës 17.02.2023 së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës: Librezën e punës me numër serik 221481; Kontratën e punës me numër protokollit 50/3 të datës 24.03.2006 të lidhur mes Entit të Kosovës për Urbanizëm, projekte, konsulting dhe inxhiniering dhe I.N; Letër reference të muajit Shkurt 2018 të lëshuar nga “Helvetas”; Formularin e vlerësimit të punës për konsulentet të datës 17.04.2018; Kontratën e lidhur mes “CDF” dhe I.N; Referencën e lëshuar nga “ Demos project, Public Spaces”; Certifikatën mbi dënimet penale të datës

VO
100
1. 5. 2023

07.02.2023 të lëshuar nga Sistemi qëndror i evidencës penale të Kosovës; Vlerësimin për punët e kryera të datës 01.11.2022 të Komunës së Prishtinës; Vlerësimin për punët e kryera të datës 03.10.2022 të Komunës së Prishtinës; Diplomën e datës 30.09.1988 me Nr.2789 e Fakultetit Teknik të Prishtinës për I.N dhe mori titullin Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës; Aplikacionin e kandidatit E.M të datës 16.02.2023 së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Transkriptën e notave të datës 04.03.2022 të lëshuar nga “Hochschule Anhalt” për E.M me korrespondim prej faqe 1-3; Diplomën me Nr.606 të datës 16.01.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti i Arkitekturës për E.M dhe mori titullin Master i Shkencave Teknike-Arkitekturës; Diplomën me numër protokolli 780/15/859 të datës 24.05.2016 të lëshuar nga Gjimnazi “Xhevdet Doda”-Prishtinë për E.M; Certifikatën e muajit dhjetor 2022 të lëshuar nga Fakulteti Teknik i Arkitekturës për E.M; Certifikatën e lëshuar nga Kosova Architecture Festival 2022 për E.M; Certifikatën e lëshuar nga “Architech” për E.M; Certifikatën me numër 100140/19 të lëshuar nga “Un-habitat Kosovo” për E.M; Certifikatën e lëshuar nga University of Applied Sciences and Arts dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” për E.M; Certifikatën e muajit Shtator 2018 të lëshuar nga “Apple” për E.M; Certifikatën e datës 03.07.2020 të lëshuar nga “European Union Kosovo” dhe Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”; Letër reference e datës 06.02.2023 e lëshuar nga “Termo com” për E.M; Certifikatën e muajit Tetor 2019 të lëshuar nga “KAF” për E.M; Njoftimin e mandatit të datës 07.07.2020 të Fakultetit të Arkitekturës për E.M; Kontratë për punë praktike të datës 01.03.2021 të lidhur mes “BP Home Invest sh.p.k” dhe E.M; Certifikatën e lëshuar nga “CRA” për E.M; Kontratën për punë dhe detyra specifike të datës 01.03.2022 të lidhur mes Komunës së Prishtinës dhe E.M; Kontratë për punë dhe detyra specifike të datës 01.07.2022 të lidhur mes Komunës së Prishtinës dhe E.M; Kontratë për punë dhe detyra specifike të datës 01.11.2022 të lidhur mes Komunës së Prishtinës dhe E.M; Vendimin me numër reference 2021/01 të datës 27.06.2022 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti i Arteve; Certifikatën me numër AP2019-192019/14 të lëshuar nga T.T për E.M; Letër referencën e datës 02.02.2023 e lëshuar nga F.J për E.M; Letër reference e datës 15.02.2023 e lëshuar nga E.D për E.M; Referencën e datës 09.11.2020 të lëshuar nga “KAF” për E.M; Referencën e datës 01.11.2019 të lëshuar nga “KAF” për E.M; Kopjen e letërnjoftimit të E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 31.01.2023 të Komunës së Prishtinës për E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 21.12.2022 të Komunës së Prishtinës për E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 01.11.2022 të Komunës së Prishtinës për E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 03.10.2022 të Komunës së Prishtinës për E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 01.09.2022 të Komunës së Prishtinës për E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 01.08.2022 të Komunës së Prishtinës për E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 01.07.2022 të Komunës së Prishtinës për E.M; Vlerësimin për punët e kryera të datës 27.05.2022 të Komunës së Prishtinës për E.M; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 01.02.2023 të lëshuar nga Sistemi qëndror i evidencës penale të Kosovës; Vërtetimin e datës 14.02.2023 të lëshuar nga Policia e Kosovës për E.M; Aplikacionin e kandidates A.SH të datës 22.02.2023 së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Certifikatën e datës 28.06.2017 të “IHS” për A.SH; Diplomën me numër 183 të datës 20.09.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë, titulli Master i Shkencave Teknike-Arkitekturës për A.SH; Diplomën me numër 1265 të datës 15.12.2015 të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”-Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë për A.SH; Diplomën me numër protokolli 651 të datës 15.06.2011 të lëshuar nga Gjimnazi “Sami Frashëri”-Prishtinë për A.SH; Certifikatën e datës 16-17.05.2020 të lëshuar nga “Ecoweek” për A.SH; Certifikatën e pjesmarrjes të lëshuar nga “Europena Union Kosovo”; Certifikatën e lëshuar nga “World Bank Grup”; Certifikatën e datës 07.04.2020 të lëshuar nga “International living future accreditation”; Certifikatën e datës 15-18.05.2016 të lëshuar nga “Regional Restoration CAMPS”; Vlerësim i datës 27.05.2016 i lëshuar nga Xhaxhiu Monument, Wood

Door; Certifikatën e datës 28.06.2016 të lëshuar nga “USAID” dhe “RIT Kosovo”; Fletë vëzhgimin; Certifikatën e datës 22.11.2015 të lëshuar nga “The Green Ark”; Certifikatën e lëshuar nga “Ecociety”; Pasqyrën e llogarisë së trustit për periudhën 28.09.2011-15.02.2023; Marrëveshjen për kryerjen e shërbimeve të veqanta me numër protokollit 01-119-42516 të datës 22.02.2016; Kontratën e punës për kohë të caktuar 12 muaj me mundësi vazhdimi të lidhur mes “Pozhegu Brothers” Sh.p.k dhe A.SH; Kontratën e punësimit të datës 01.05.2020 të lidhur mes “Urban Plus” dhe A.SH; Certifikatën e datës 21.02.2022 të lëshuar nga “Graphisoft”; Certifikatën e datës 07.06.2020 të lëshuar nga “Auto Desk”; Letër reference e datës 28.09.2016 të lëshuar nga Komuna e Prishtinës; Letër rekomandimi me numër protokollit 1034 të datës 19.05.2020 të lëshuar nga “Pozhegu Brothers”; Kopjen e letërnjoftimit të A.SH; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 22.02.2023 të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale të Kosovës; Aplikacionin e datës 18.02.2023 të kandidatit K.A së bashku me përgaditjen profesionale dhe atë të përvojës së punës; Diplomën me numër 1143 të datës 17.06.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë; Certifikatë e datës 21.02.2023 e lëshuar nga “Global” Digital Kosovo; Vërtetimin me numër 14-113/01-38082/23 të datës 22.02.2023 të lëshuar nga Sektori i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës; Vërtetimin me numër protokollit 04-03/569/1 të datës 16.02.2023 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore; Letër referencë e datës 17.07.2017 të lëshuar nga Komuna e Prishtinës; Kopjen e letërnjoftimit të K.A; Formularin për vlerësimin e performancës në punë me numër protokollit 04-03/15934 të datës 22.02.2023 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore; Formularin për vlerësimin e performancës në punë të datës 22.11.2021 të lëshuar nga Ndërmarrja Publike Banesore; Certifikatën mbi dënimet penale të datës 22.02.2023 të lëshuar nga Sistemi qendror i evidencës penale të Kosovës; E-maili i datës 16.10.2023 nga zyrtarja e personelit e cila ka dërguar vlerësimet individuale nga Komisioni Vlerësues për ankuesen dhe kandidatët.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Komuna e Prishtinës, me datë 25.08.2023, ka publikuar në sistem qendror elektronik (SIMBNJ) Konkursin e hapur, me numër reference RN00010816, për emrin e grupit “*Specialist të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane/pozita Zyrtar i Lartë për planifikim dhe zhvillim*”, klasa Profesionale 1, tri vende, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 16.02.2023 deri me 23.02.2023, me ç’rast lista e ngushtë ka vijuar me 19 kandidatë që kanë plotësuar kriteret e konkursit.

Bazuat në Njoftimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës të datës 29.08.2023, si kandidat të suksesshëm për emrin e grupit “*Specialist të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane/pozita Zyrtar i Lartë për planifikim dhe zhvillim*” janë shpallur Endrit Micini me gjithsej 83 pikë, Arianisa Shehu me gjithsej 79.8 pikë dhe Kushtrim Ademi me gjithsej 79.4 pikë, kurse, sipas Renditjes Përfundimtare të datës 18.08.2023 të Komisionit të Pranimit, rezulton së ankuesja është vlerësuar me gjithsej 73.6 pikë.

Në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar ligjshmërinë e veprime procedurale që përbejnë tërësinë e procesit të rekrutimit sipas Konkursit me numër reference RN00010816, për emrin e grupit *Specialist të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane*, respektivisht pozitën *Zyrtar i Lartë për planifikim dhe zhvillim në Komunën e Prishtinës*, dhe si rrjedhojë, Kolegji nga analizimi i aktit të shpalljes së konkursit ka

konstatuar se si kritere formale për pozitën përkatëse të punës janë përcaktuar: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS. Fakulteti i Planifikimit, Arkitekturës; ° Përvoja e punë se kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, dhe rrejdhimisht, Kolegji ka gjetur së fushat e specifikuar të arsimit për këtë pozitë të punës nuk janë në pajtim me Shtojcën Nr.2 të Rregullores QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sepse, sipas kësaj rregullore gjegjësisht sipas Shtojcës numër 2 të rregullores, për emrin e grupit *Specialist të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane*, me kod nr. 42, si fusha të arsimit janë përcaktuar Arkitekturë/Urbanistikë, Planifikim Qytetesh dhe Gjeografi, pra, Komuna e Prishtinës në aktin e shpalljes së Konkursit me numër reference RN00010816, nuk ka përfshirë si fushë të arsimit gjeografinë.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizim i dokumentacionit të aplikimit lidhur me kandidatet e suksesshëm ka konstatuar se: kandidati E.Mecini lidhur me kriterin e arsimit posedon Diplomën me numër 606, me të cilën dëshkohet së ka përfunduar studimet në master Departamenti i Arkitekturës në Fakultetin e Arkitekturës - Universiteti "Hasan Prishtina", kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës ka prezantuar si dëshmi: Kontratën e punës të datës 01.03.2021, sipas të cilës E.Micini, ka kryer punën praktike të biznesi "BP Home Invest sh.p.k", në kohëzgjatje nga 01.03.2021 deri me 31.03.2021, Kontratën e punës të lidhur me datë 01.03.2022, sipas të cilës ka qenë në marrëdhënie punë në Komunën e Prishtinës në pozitën e punës Bashkëpunëtor Administrativ për Legalizim në kuadër të Drejtorisë së Urbanizimit, për periudhën nga data 01.03.2022 deri me datë 30.06.2022, Kontratën e punës të lidhur me datë 01.07.2022, sipas të cilës ka qenë në marrëdhënie punë në Komunën e Prishtinës, në pozitën e punës Bashkëpunëtor Administrativ për Legalizim, në kuadër të Drejtorisë së Urbanizimit, për periudhën nga data 01.07.2022 deri me datë 31.10.2022, Kontratën e punës të lidhur me datë 01.11.2022, sipas të cilës ka qenë në marrëdhënie punë në Komunën e Prishtinës, në pozitën e punës Bashkëpunëtor Administrativ për Legalizim, në kuadër të Drejtorisë së Urbanizimit, për periudhën nga data 01.11.2022 deri me datë 28.02.202, Referencën e datës 01.11.2019, të lëshuar nga Drejtori i OJQ-së "Kosova Architecture Foundation" me të cilën dëshkohet e kandidati E.Mecili ka qenë i angazhuar në rolin e Koordinatorit të Arkitekteve në Festivalin e Arkitekturës për vitin 2019, dhe si detyrë kishte mbledhjen e të dhënave urbane për punëtoritë "Internacional Public Space", Referencën e datës 09.11.2020 të lëshuar nga Drejtori i OJQ-së "Kosova Architecture Foundation", me të cilën e dëshmon se kandidati E.Mecini, ka qenë i angazhuar në rolin e Koordinatorit të Arkitekteve në Festivalin e Arkitekturës për vitin 2020, dhe si detyrë kishte mbledhjen e të dhënave urbane dhe arkitektonike për punëtoritë e organizuar gjatë KAF2020, Referencën e datës 06.02.2023 të Drejtorit të Ndërmarrjes ndërtimore private "Termo CoM", sipas të cilës kandidati në fjalë ka punuar si arkitekt në këtë kompani private nga data 01.06.2019 deri me 30.09.2021. Rrjedhimisht, nga analizimi këtyre provave Kolegji konstaton së kandidati i përzgjedhur E. Micini nuk ka prezantuar diplomë për përfundimin e studimeve themelore me 180 kredi/ECTS, por i njëjti ka dorëzuar vetëm diplome për përfundimin e studimeve master, e që në vlerësimin e Kolegjit, kriteri i arsimit për pozita të kategorisë profesionale duhet të dëshkohet me diplomë të studimeve themelore. Ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës kandidati E. Micini ka ofruar dëshmi të vlefshme lidhur me përvojën e punës si praktikant në kohëzgjatje prej një (1) muaji tek biznesi "BP Home Invest sh.p.k si dhe përvojën e punës në Komunën e Prishtinës në kohëzgjatje prej 1 viti, ndërsa, lidhur përvojën e punës në OJQ "Kosovo Architecture Found" dhe në Ndërmarrjes ndërtimore private "Termo CoM" ka ofruar vetëm referenca të punës, duke mos e dëshmuar edhe me dokumente përcjellëse nga Trusti Pensional i Kosovës apo Administrata Tatimore e Kosovës. Rrjedhimisht, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, përvoja e punës në sektorin privat e provuar vetëm përmes referencës së lëshuar nga punëdhënësi nuk është dëshmi e mjaftueshme dhe e vlefshme

nëse të njëjtat nuk janë të shoqëruara edhe me vërtetim nga organet kompetente, gjegjësisht Administrata Tatimore apo Trusti Pensional, standard ky tani me i vendosur edhe nga Gjykata e Apelit e Kosovës, ku si rrjedhojë me Aktvendimin me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës theksohet fakti se dëshmitë e përvojës së punës në sektorin privat duhet të mbështeten edhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës apo dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës. Kurse, përvoja e punës në OJQ dëshmohet me statutin apo aktin tjetër të organizatës se pozita në të cilën është deklaruar përvoja e punës, ekziston në kuadër të organizimit dhe funksionimit të OJQ –së; Aktin e emërimit apo caktimit me votim të organeve që sipas statutit të OJQ –së, kanë kompetencën për të emëruar/caktuar personat në pozitën e caktuar në OJQ si dhe pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, ose pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale ose të ardhurave tjera të tatueshme.

Për sa me sipër dhe duke qenë se nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se kandidati i përzgjedhur E. Micini me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, lidhur me plotësimin e kriterit të përvojës së punës, ka ofrua dëshmi të vlefshëm vetëm për periudhën në kohëzgjatje prej një (1) viti e një (1) muaj, atëherë, Kolegji i Këshillit vlerëson se kandidati i përzgjedhur E. Micini nuk ka plotësuar kërkesat formale për pozitën e shpallur sipas Konkursit me numër të referencës RN00010816, dhe mbi këtë konstatim rrjedhë së Njësia e Burimeve Njerëzore si njësi përgjegjëse pranë Komunës së Prishtinës nuk ka zbatuar drejtë ligjin material me rastin e vlerësimit të aplikacioneve në fazën e verifikimit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 15 paragrafët 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet së: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim.2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtës.*

Po ashtu, Kolegji duke u bazuar në Renditjen Përfundimtare të kandidatëve të datës 18.08.2023, ka konstatuar se kandidati _____ dhe _____ ka rritur numër të barabartë të pikëve gjithsej 79.4 % të pikëve dhe sipas Komunës së Prishtinës përzgjedhja e Kushtrim Ademit si kandidat i suksesshëm është bërë mbi faktin se vet sistemi e ka renditur si kandidatin e tretë të suksesshëm. Një veprim i tillë sipas vlerësimit të Kolegjit të Këshillit nuk ka mbështetje ligjor dhe është në kundërshtim të plotë me nenin 27 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar: *Kandidatët me pikë të barabarta renditen dhe kanë të drejtë të zgjedhin pozitën e punës sipas kësaj radhe: 1.1. se pari nëse njëri prej kandidatëve përfshihet në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, atëherë ai përzgjidhet i pari në raport me kandidatin tjetër, nëse përfaqësimi është më i vogël se kuotat e rezervuara; 1.2. se dyti, nëse njëri nga kandidatët është nga radhët e një komuniteti jo shumicë atëherë ai përzgjedh i pari në raport me kandidatin tjetër, nëse përfaqësimi është më i vogël se kuotat e rezervuara; 1.3. së treti nëse kandidatët janë të gjinive të ndryshme, atëherë ka të drejtë të përzgjedhë i pari kandidati që i përket gjinisë të nënperfaqësuar. Gjinia më pak e përfaqësuar përcaktohet nga Njësia Përgjegjëse dhe 1.4. në rast se nuk mund të aplikohet asnjëra nga alternativat e parapara në nën paragrafët 1.1 deri 1.3 të këtij neni, atëherë personi që ka të drejtë të përzgjedhë më së pari përcaktohet me short” pra, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe meqenëse në rastin konkret nuk është i zbatueshëm kriteri i përfaqësimit gjinor, i personave me aftësi të kufizuar apo i komuniteteve jo shumicë, atëherë, përzgjedhja e kandidatit të suksesshëm nga kandidatet me pikë të barabarta duhet të behej me short.*

Andaj, nisur nga konstatimi se procedura e pranimit sipas Konkursit me numër reference RN0001086 për emrin e grupit Specialist të Planifikimit dhe të Arkitekturës Urbane në Komunën Prishtinë është përfshirë me shkëlqje ligjore të cilat në tërësi e bëjnë juridikisht të pavlefshme këtë procedurë të pranimit, Kolegji duke u bazuar në nenin 53 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1117/2023

Ilire Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetrari të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPSHCK-së